

Editorial/

## NJERIU DHE PUSHTETI

Nga Justinian Topulli



Është në natyrën e njeriut të kërkojë pushtet mbi sendet, madje një nga tundimet më të mëdha që e josh atë së tepërmi. Shpesh qytetërimi njerëzor në çdo etapë të tij lexohet pikërisht si një përpjekje e vazhdueshme e njeriut për të sunduar mbi botën, për të zotëruar dhe pasur pushtet mbi çdo gjë që e rrethon.

E parë në këtë këndvështrim, zhvillimi teknologjik është prirja e njeriut për të sunduar mbi botën materiale. Njohuria e tij për botën nuk nxitet vetëm nga kërkuesit që ai ka për të njohur çdo gjë, por edhe për ta sunduar atë. Shpikja e veglave, zhvillimi i teknologjisë, zbutja e kafshëve, modifikimi gjenetik i qenieve të gjalla, qofshin këto bimë apo kafshë, etj. vjen edhe si shkak i synimit të njerëzve për të pasur kontroll dhe pushtet mbi objektet që e rrethojnë. Por, padyshim sfida më e madhe për njeriun është pushteti i tij mbi sojin e tij, është përpjekja për të ngadhënjyer mbi dobësitë e tij si qenie njerëzore, që ia kufizojnë atij pushtetin, pra mbi vetveten dhe mbi të tjerët. Një nga këto dobësi dhe më rëndësishme është vdekja. Asnjë pushtet sado i madh dhe i shtrirë që të jetë, nuk mund të jetë i plotë nëse nuk është i përjetshëm. Kështu pra, që lufta për të ngadhënjyer mbi vdekjen dhe fituar përjetësinë, motivohet edhe nga dëshira për pushtet të përjetshëm. Shpesh joshja e njeriut për të pasur pushtet mbi

llojin e tij është më e madhe dhe më e kënaqshme për të, sesa pushteti mbi objektet e pajetë e të palogjikshëm. Dhe pikërisht për këtë, ai e ndjen veten të pushtetshëm, pra vetëm kur ndjen pushtetin e tij mbi njerëzit e tjerë dhe jo thjesht mbi sendet dhe objektet materiale, të cilat nuk ia kënaqin atij egon e pushtetit aq sa duhet. Një nga format e shfaqjes së kësaj prirje është edhe përpjekja e njeriut për t'ua imponuar të tjerëve mendësinë e tij, duke dashur që edhe të tjerët të mendojnë dhe veprojnë si ai, ose ashtu siç dëshiron ai për ta. Sepse, natyrisht vetëm kështu ai mund të arrijë ta ndjejë vërtetë pushtetin e tij mbi të tjerët.

Revolucioni industrial, zhvillimi i shkencave humane dhe përmbysjet e njëpasnjëshme që kanë ndodhur dhe po ndodhin veçanërisht në këto dy shekujt e fundit, nuk janë – sipas leximit të mësipërm – veçse një përpjekje e intensifikuar tej mase, për rritjen e pushtetit të njeriut, qoftë kjo mbi botën materiale, qoftë kjo mbi racën humane. Mirëpo, është e çuditshme që çdo njeri në vetvete sado i pushtetshëm që të jetë dhe sado që i ndjen kufizimet që i japin dobësitë e tij, përsëri ai kërkon të riprodhojë vetveten, kjo sepse ai mendon se në thelb ai është më i miri, duke e imagjinuar veten shpesh si një rast tejet i veçantë dhe ndoshta i papërsëritshëm, për veçantinë që ka, dhe se vetëm sfida me kohën

është ajo që e pengon atë si individ të bëhet më i përsosuri. Pikërisht nisur nga kjo ego e njeriut, ai nuk kërkon një botë dhe njerëz ndryshe nga çfarë ai është në thelb, apo si i imagjinon dhe i ëndërron ai, por kërkon një riprodhim të vetvetes dhe dëshirave të tij. Dhe pikërisht kjo ego e shtyn atë, ndër të tjera të kërkojë përjetësimin e tij në këtë botë me mënyra nga më të ndryshmet. Një nga këto mënyra, sipas tyre, mund të jetë edhe klonimi gjenetik, ku disa njerëz mendojnë se nëpërmjet tij do të mund të përjetësojnë trupin, dëshirat dhe ëndrrat e tyre! Disa të tjerë kërkojnë ta përjetësojnë pushtetin e tyre nëpërmjet ideologjive, të cilat ata i shohin si finale dhe të përfundme, duke dashur kështu të kthehen në zota të hyjnizuar prej njerëzve. Ka njerëz iluzionar që ëndërrojnë se

mund ta përjetësojnë vetveten duke e digjitalizuar atë dhe ta zhvendosin atë të jetojë në botën kibernetike, e prej andej të vërtiten ndërmjet kësaj dhe asaj bote! Të tjerë në mënyrë klasike, duan ta arrijnë këtë nëpërmjet diktaturës..., e rëndësishme për ta është të përmbushet kjo dëshirë e pandalshme për përjetësi dhe pushtet, pa mjeti pak rëndësi ka.

E pra është pikërisht ky instinkt i brendshëm njerëzor, që dreqi e pikasi dhe e shfrytëzoi, për ta joshur atë drejt përjetësisë dhe pushtetit të përjetshëm: **“Por djalli e cyti: “O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?”** (Kurani, 20:120)

Dhe përfundimi dihet... një mirazh pas të cilit ai do të rend pa e arritur kurrë atë!

### Fq. 2/ Të edukosh a të arsimosh?

.....Përgatiti: Dorian Balliu

### Fq. 4/ Duke zbuluar dhe shpjeguar Sheriatin

.....Përgatiti: Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë

### Fq. 6 / Roli i shoqërisë civile në luftën kundër islamofobisë ...Nga Xhibangir Ishbilir

### Fq. 7 / Muslimanët e kapërcyen Atlantikun përpara Kolombit .....Nga Firas El-Hatib

## TË EDUKOSH A TË ARSIMOSH?

Përgatiti: Dorian Balliu


*Vetëm edukimi i mirë,  
krahas arsimimit të shëndoshë,  
mund të jetë pendë e fortë  
që qetëson rrebeshtet e jetës.*

Njeriu vetëm duhet të arsimohet apo njëkohësisht edhe të edukohet, të zgjohet ajo që është fisnike në karakterin e tij?

Jo vetëm që çdo religjion botëror dhe çdo kulturë botërore e ka shtruar këtë pyetje, por vetë religjionet dhe vetë kulturat njëkohësisht janë përgjigje të kësaj pyetje. Në kohët e globalizimit ku po jetojmë kjo pyetje është në vetë boshtin e jetës së shumë shoqërive, veçanërisht, atyre të lindura në ideologjitë e iluminizmit. Sepse, shekulli XIX dhe XX kanë sjellur me vete për herë të parë në histori fenomenin në të cilën dija dhe arsimimi nuk janë më vetëm çështje e elitës së dijetarëve, klerikëve, fisnikëve apo sunduesve. Shkollimi dhe arsimimi, së paku gjatë dy shekujve të fundit, gjithkund është bërë i mundshëm për të gjithë. Dhe nuk do të kishte asgjë të keqe sikur arsimimi të mos zbrazej nga edukimi, sikur të mos masovizohej, d.m.th., dija me klishtë e reja u është transmetuar nxënësve, studentëve, njerëzve në mënyrë masive, kështu ata shikohen si masa, por edhe qenë shndërruar në masë. Se masa vetëvetiu është nocion fizik, në masë jo vetëm që nuk shihet asnjë figurë, por në të humbet çdo figurë, çdo veçanti individuale. Për këtë arsye shumë ideologji poliforme të shekullit XIX dhe XX edhe në Perëndim edhe në Lindje, sidomos ato që kanë ardhur në pushtet, kanë pasur në programet e tyre politike “arsimimin e masave popullore”. Prej “arsimimit të masave popullore” deri tek mësimdhënia e tyre ka mbetur vetëm një hapë i vogël. Regjimet totalitare, atje ku kanë arritur të vijnë në pushtet, këtë hap, sikur që është i njohur, e kanë ndërmarrë. Por, jo vetëm që në këtë “arsimim masiv” pranuesit e dijes janë reduktuar në masë, por edhe vetë dija është bërë masë, është transmetuar si masë e fakteve të izoluar, të veçuara të ndonjë disipline. Fizika më vete, kimia më vete, biologjia më vete. Shkencat po kështu, ato gjatë shekullit XIX dhe XX janë autonomizuar dhe atomizuar. Trajtimi i diturisë si masë faktesh, e cila, nga një anë, me medime të arsimimit masiv u transmetohet publikut milionësh të shkollave fillore,

nxënësve dhe studentëve dhe, nga ana tjetër, ndahet brenda disiplinave të veçanta dhe reciprokisht të izoluar, të cilat gjatë kohës janë tëhuajësuar njëra prej tjetrës. Kjo ka çuar në pasoja e tmerrshme: e tërë kjo, nga këndi i arsimimit modern, sot nuk shikohet si në tërësi.

Konceptet e arsimimit të themeluara kështu masivisht gjatë dy shekujve të kaluar gjithnjë e më shumë e kanë shpërfillur edukimin e nxënësve, edukimin e individit. Shkollimi ka pushuar së qënuri edukim. Pasojat jo vetëm që kanë qenë fatale, por edhe të pashmangshme. Për këtë nuk ka nevojë për shumë fakte. Tmerret e Holokaustit i kanë krijuar akademikët të mirë arsimuar, por të paedukuar. Spastrimet etnike janë pasoja e projekteve të mendimeve të



profesorëve të mirë arsimuar, por të paedukuar. Për këtë sot po shkruhet shumë, sikur edhe për katastrofën ekologjike të përpjestimeve planetare. Civilizimet e lashta janë rrënjësuar rreth lumenjve dhe gjireve detare. Arsimimi bashkëkohor dhe armata e njerëzve sipas tij të arsimuar, por të paedukuar i kanë helmuar këta gjire dhe lumenj. Më së paku disa dhjetra qytete të mëdha botërore janë në duar të njerëzve të arsimuar, por jo të edukuar në shekullin e njëzet, në Perëndim edhe në Lindje. Xhelaluddin Rumi ka thënë: “Njeriu të arsimuar, por të paedukuar, truri i shërben sikur edhe vjedhësit qiriri në kohën që ai vjedh!”. Ka dhjetë vjet që rregullisht dëgjojmë lajmet që tregojnë se si ndonjë nxënës

ose disa nxënës, pikërisht në shkollën e tyre, me mjete automatike kanë vrarë, apo e kanë plagosur gjysmën e klasës. Këto lajme dhe këto dukuri tanimë po analizohen. Por, ajo që po i shpëton shumicës pa e vërejtur, është se lajmet e këtilla janë vetëm lajme mbi pasoja, jo për shkaqet. Shkaqet janë shumë më të thella edhe në Perëndim edhe në Lindje, dhe të vjetra thuajse dy shekuj e gjysmë. Arsimimi masiv dhe shkolla bashkëkohore i pret nxënësit me kabinete të rregulluara, me programe dhe libra shkollorë arsimore efikase. Por, librat shkollorë të fizikës moderne nuk përmbajnë as shenjë mbi turpin. Librat e kimisë moderne nuk përmbajnë asnjë fjalë mbi turpin. Librat shkollorë mbi biologjinë nuk përmbajnë as iluzione mbi modestinë. Sikur, njeriu, të themi, të jetë njeri

arsimimit, por të pastrohesh me ujë - është çështje e edukimit, kulturës. Ta dish formulën e sapunit dhe ta bësh atë është çështje e shkencës, por, ta përdorësh sapunin kur ke nevojë, është çështje e edukimit. Ta robërosh kundërshtarin në luftë është çështje e shkathtësisë dhe dijes ushtarake, por t'ia kursesh jetën dhe t'ia ruash dinjitetin është çështje e edukimit. Sistemet bashkëkohore do të duhej të përkujtojnë në shqyrtimet klasike mbi shpirtin dhe edukimin e njeriut. Do të duhej t'i kthehen mësuesve të lashtë të njerëzisë të cilët e kanë përcaktuar fushën e arsimimit dhe të edukimit. Sic është arsimimi ushtrimi i aftësive mendore, ashtu edhe edukimi është iluminimi i ndërgjegjjes së brëndshme, iluminimi i vetë zemrës. Arsimimi dhe edukimi janë dy anë të barabarta të ngritjes dhe drejtimit shpirtëror të njeriut, pikërisht si shpendi që fluturon barabarësisht me të dy krahët e vet. Kurse në arsimimin e sotëm këto anë janë në disproporcion. Arsimimi pa edukatë synon të shndërrohet në forcë rrënuese mbi natyrën dhe mbi shoqërinë njerëzore. Edukimi pa arsimim, ndonëse sjell deri te ngritja dhe drejtimi moral, gjatë kohës zbehet dhe transformohet në ngushëllim si i vetmi vendstrehim. Arsimimi dhe edukimi nuk janë procese që njeriu i arrin njëherë e përgjithmonë, sic i fiton dhembët e përhershëm pas atyre të qumshtit. Arsimimi dhe edukimi janë procese të gjata dhe përtëritëse, të cilave gjithnjë duhet t'u kthehem. Ashtu si shpendi, që të mbahet në ajër, vazhdimisht i lëviz të dy krahët e vet.

### Turqia do të ndërtojë xhami në çdo univeristetet.

Drejtorja për çështje fetare pranë Qeverisë turke lajmëroi se do të ndërtojë xhami në kampusin e secilit universitet shtetëror në vend.

“Në proces të ndërtimit janë xhamitë në mbi 80 universitete. Pesëmbëdhjetë prej tyre tashmë janë të hapura për besimtarët dhe do të hapim 50 të tjera gjatë vitit 2015”, deklaroi Mehmet Gurmez, shef i Drejtorisë për çështje fetare.

“Ka 20 milionë të rinj në vendin tonë dhe ne dëshirojmë të arrijmë tek secili prej tyre”, sqaroi Gurmez, cituar nga Anadoluja. Sipas tij, imamët të cilët marrin rroga nga qeveria në pajtim me ligjet në Turqi, do të jenë përgjegjës që në çdo xhami t'u ofrojnë ndihmë të rinjve të cilët janë në gjendje të rëndë.

“Ne u kushtojmë rëndësi të madhe xhamive nëpër universitete. Kjo është mënyra e vetme që xhamitë të kthehen në jetën, qytetet dhe zemrat e njerëzve tanë”, theksoi Gurmez.

Edukimi zë fill në kulturë, kultura në fe, kurse feja ka origjinë hyjnore, Zotin. Të jesh hidraulik, të dish dhe ta rregullosh ujësjellësin – është çështje e

#### Bordi botues:

Justinian TOPULLI

Genc PLUMBI

Mustafa TËRNIQI

#### LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: “Teodor Keko” Pallati Edglis, Tiranë-Shqipëri

lidhjahoxhallareve@yahoo.com

Tel & Fax: +355 (0)48320160

http://www.lidhjahoxhallareve.com

# Konferencë për bankën islame

Në bankën islame rreziku ndahet me klientin, në bankën komerciale kryesisht rreziku i ngarkohet vetëm klientit.

Në bibliotekën e Gazi Husrevbeut në Sarajevë të Bosnjës dhe Hercegovinës ka filluar konferenca dyditore ndërkombëtare për bankën islame me titull: "Sarajevo Islamic Finance and Economics Conference 2014". Konferenca është organizuar nën emërtimin "Sfidat e reja për ekonominë islame dhe zhvillim të financave", dhe bëhet fjalë për të vetmin konferencë të tillë nga fusha

lejojmë polarizimin në shumë të pasur dhe shumë të varfër. Njëra nga përgjigjet e tilla duhet kërkuar edhe në këtë konferencë", ka thënë Shaini. Duke treguar se kamata në sistemin bankar islam është "haram" gjegjësisht e ndaluar, Shaini ka thënë se çmimi i parasë së huazuar ka tejkaluar çdo masë dhe se është një nga burimet e destabilitetit në botë. Profesori I të drejtës bankare në Fakultetin Ekonomik në Sarajevë Fikret Haxhiqi i cili është njëri nga organizatorët e këtij takimi, para fillimit të konferencës ka thënë

se problemi i vetëm është kamata, por sipas meje ndryshimi është shumë më i madh, pasi në bankën islame rreziku ndahet bashkërisht me klientin dhe bashkërisht hynë në projekte me klientët, ndërsa banka komerciale kryesisht rrezikun ia ngarkon klientit", theksoi Kozariqi.

Ai mendon se dimensionin social dhe përgjegjësia shoqërore e bankave është e shprehur qartë në bankën. Në pyetjen e gazetarit lidhur me faktet se institucionet në BeH më tepër marrin hua nga bankat komerciale, dhe nuk shkojnë tek bankat islame, Kozariqi ka thënë se ekziston një ngatërrim, të cilin kjo konferencë do të duhet të largojë: - "Banka islame nuk është vetëm për mysliman. Nga ana tjetër afro 80% e myslimanëve në botë nuk kanë qasje në bankën islame", ka thënë Kozariqi. Ai theksoi se duhet të rritet ndërgjegjësia e qytetarëve në lidhje dhe mundësinë e bankimit islam. Në kuadër të konferencës dyditore do të trajtohen çështjet bashkëkohore në fushat e ekonomisë islame dhe financave islame, e veçanërisht "sukuku"- bonoja islam. Financat islame paraqesin një nga segmentet më të shpejta të rritjes së financave globale të cilat tërheqin vëmendjen jo vetëm të teoricienëve por edhe të praktikantëve.

Për këtë konferencë janë paraqitur mbi 100 punime të autorëve nga 22 shtete, e në konferencë do të prezantohen vetëm 30 punime të zgjedhura. Fjalën hyrëse do të mbajë dr. Zheljko Shaini, dekan i Fakultetit Ekonomik në Sarajevë, dr. Abdul Gafar nga Islamic Research and Training Insitut, si dhe ambasadori i Britanisë së Madhe në BeH Edward Ferguson.

Qëllimi kryesor i Konferencës është të grumbullojë ekspertët nga fusha e ekonomisë islame, të financave dhe bankave, të cilët do të prezantojnë punimet e tyre hulumtuese shkencore, por edhe të

shkëmbejnë përvojat nga kjo fushë e rëndësishme shkencore.

ka dalë se vetëm 10% e femrave me shami janë mbuluar para 1997, më pas ky numër ka ardhur duke u rritur dhe deri në 2011 numri i femrave me shami është 9 fishuar. Nëse këto femra do mbuloheshin sepse ishin të vogla dhe injorante dhe familja i detyronte atëherë numri i tyre me kalimin e viteve do ulej sepse ato do rriteshin dhe do shkolloheshin, dhe me emancipimin e shoqërisë edhe ato do të "emancipoheshin". Por ne shohim që ka ndodhur e kundërta, numri i tyre është shumëfishuar. Pra edhe kjo e dhënë hedh poshtë pretendimet që ngrihen ndaj femrave me shami.

Pra, si rezultat i këtij studimi del se në realitetin e sotëm shqiptar, me mbulimin e femrave lidhet problemi i ushtrimit të presionit social, që shkon në raste të veçanta deri në ushtrimin e dhunës fizike, për të hequr mbulimin dhe jo në atë të detyrimit forcor për t'u mbuluar.



e ekonomisë islame në këtë pjesë të Evropës. Organizator është shoqata evropiane për ekonominë islame, banka dhe financa në bashkëpunim me partnerët tjerë.

Dekani i fakultetit ekonomik në Sarajevë prof. dr. Zheljko Shaini theksoi se kamata është njëra nga burimet e jostabilitetit në botë, jo e vetmja, por njëra prej burimeve. Sistemi bankar Islam, mund të ndihmojë në të vërtetë, pasi botë jeton një bashkësi shumë e madhe islame. Ndaj është normale që ky sistem të jetë mënyra më korrekte e këndvështrimit për zhvillimin e ardhmërisë se ajo e fajdesë në të cilin bota e tanishme bazohet në profit apo kamatë. Ai shtoi se kjo konferencë është ngjarje e madhe jo vetëm për Bosnjën dhe Hercegovinën por edhe për tërë botën.

"E tërë bota gjendet para sfidave të reja. Si të organizohen financat e reja, zhvillimi i ri ekonomik, pasi forma e zhvillimit aktual nuk çon tek e mira. Duhet të punojmë në balancimin e zhvillimit ekonomik dhe shfrytëzimin racional të mjeteve financiare kudo. Nuk mund të

se qëllimi i konferencës është promovimi i bankës islame, financave islame, gjegjësisht një mënyrë tjetër të ushtrimit të veprimtarisë financiare. Për këtë arsye në konferencë kemi ftuar edhe zyrtarët të cilët do të mund të ndikonin në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit i cili do të krijojë më shumë hapësirë për këtë lloj të veprimtarisë financiare. Ndaj presim që Bosnja dhe Hercegovina mund të paraprijë në rajon por edhe më gjerë me këtë qasje të tërheqjes së kapitalit islam gjegjësisht kapitalit nga shtetet islame", ka thënë Haxhiqi dhe ka shtuar se qëllimi i kësaj konference është që kjo mënyrë e biznesit financiar të jetë sa më atraktive.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Bosnjës dhe Hercegovinës ka thënë se konferenca është rast që të thuhet diçka për kornizën juridike për islam bankar, pasi në Bosnjë e Hercegovinë nuk ka. Ai ka nënvizuar se në BeH në principet e bankimit islam vepron vetëm një bankë, por siç ka thënë ai, nuk janë promovuar mjaftueshëm të gjitha benifitet që ofron banka islame, në të cilin duhet punuar. "Njerëzit mendojnë

**Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë**  
رابطة أئمة ألبانيا  
**The Albanian Imam's League**

www.lidhjahoxhallareve.com  
Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)  
P. Eglis, Kati III, Tirana-Albania  
Mob1: 00 355 672304520  
Mob2: 00 355 672753789  
E-mail: lidhjahoxhallareve@yahoo.com

**MBLEDH ZEKATIN TUAJ**

Për zekatin në lekë:  
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB  
Llogaria në lekë:  
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA  
Llogaria në Euro:  
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO  
Llogaria në Dollarë:  
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

**Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë**  
Tel: 0672304520 /0672538334/048320160  
BKT Banka Kombëtare Tregtare  
Nr. i llogarisë : 52416329

# Duke zbuluar dhe shpjeguar Sheriatin

Përgatiti: Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë

Hyrje

Termi shariat sot është bërë mjaft i njohur, si për muslimanët ashtu edhe për jomuslimanët, për shkak të përmendjes së shpeshtë që i bëhet në media dhe lajme. Por, çfarë kuptimi ka në fakt termi shariat?

Në gjuhën arabe fjala shariat do të thotë: rruga e qartë ose rruga që të shpie drejt ujit. Në kuptimin islam kjo fjalë përdoret për të treguar fenë që ka ligjësuar Zoti për njerëzimin. Kuptimi gjuhësor i fjalës shariat pasqyrohet edhe në kuptimin e tij terminologjik: ashtu siç është i domosdoshëm uji për jetën biologjike njerëzore, ashtu edhe qartësia dhe pastërtia e Sheriatit është uji jetësor i shpirtit dhe i mendjeve njerëzore.

Sheriati gjykon të gjitha aspektet e jetës së një individi musliman. Ligjet e Sheriatit nxirren nga një grup burimesh, që përfshijnë Kuranin fisnik, Hadithin (fjalët, veprat dhe miratimet e Profetit) dhe pas tyre, gjykimet që japin dijetarët muslimanë, nëpërmjet ixhmait (konsensusit), kijasit (analogjisë), urfit (traditës) dhe maslahas (interesit).

Shumë njerëz, në mes tyre edhe disa muslimanë, e kanë keqkuptuar Sheriatin, ata në shumë raste Sheriatin e lidhin me prerjen e gjymtyrëve, vrasjen me gurë, rrahjen me kamxhik si dhe ndëshkime të tjera. Ndërkohë në perëndim ka njerëz që e shohin Sheriatin si një kod idesh të vjetra sociale, të cilat iu imponohen njerëzve që jetojnë në vendet ku sundon Sheriati dhe të cilave u ka ikur koha dhe janë të padrejta.

Pavarësisht këtyre opinioneve, shumica e muslimanëve e shohin Sheriatin krejt ndryshe. Ata e kanë parë Sheriatin gjatë gjithë trashëgimisë islame si diçka që ka shërbyer për edukimin e racës njerëzore. Sheriati në vështrimin e tyre nuk është diçka primitive, por diçka e shenjtë. Sheriati për shoqëritë me probleme sociale shihet si çlirues i njeriut në mënyrë që ai të kuptojë dhe të njohë mundësitë e fshehura që mbart.

## Shtegu i drejtë

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj (shariat) dhe një rrugë të qartë (minhaxh). Sikur të donte Allahu, do t’ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t’ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni tek Allahu e Ai do t’ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti.”** (Kurani 5:48)

Zoti i Lartësuar ka caktuar për shpirtin e çdo njeriu një periudhë të limituar kohe, të cilën ai do ta kalojë në tokë, për t’u testuar gjatë qëndrimit në të. Pas përfundimit të kësaj periudhe të përcaktuar për të, Ai do ta gjykojë dhe do ta dërgojë atë në botën tjetër: në kënaqësinë e përjetshme ose në ndëshkimin e përhershëm.

Pra, kjo jetë i shëmbëllen një udhëtimi, që e shpie njeriun që jeton në të, në shtigje të shumta, por diku në të -në mes gjithë këtyre shtigjeve- ka vetëm një shteg të qartë dhe të drejtë dhe ky shteg për muslimanët është Sheriati.

## Udhërrëfim hyjnor

Allahu ka dërguar Profetë gjatë gjithë kohës te njerëzit në mbarë botën i ka dërguar për t’i udhëzuar ata në shtegun e drejtë, shteg që i shpie drejt lumturisë së kësaj bote dhe botës tjetër. Të gjithë Profetët e dërguar kishin të njëjtin besim, por veçantitë e ligjeve qiellore (shariateve) të tyre ndryshonin në përshtatje me nevojat njerëzore që kishte çdo vend dhe kohë. Sheriati pasqyron shpalosjet reale dhe shembullore të mëshirës hyjnore, Allahu i Lartësuar thotë: **“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj.”** (Kurani 5:3)

Ndërkohë për Profetin e Tij, Ai thotë: **“Ty të dërguam vetëm si mëshirë për mbarë botët.”** (Kurani 21:107)

## Dispozitat e Sheriatit

Sheriati rregullon gjithë veprimtarinë njerëzore dhe e klasifikon atë në pesë grupe:

- E detyruar (el-uxhub)
- E preferuar (en-nedeb)
- E lejuar (el-ibaha)
- E urryer (el-kerahije)
- E ndaluar (el-haram)

Veprat e detyruara duhet të kryhen dhe të shoqërohen me qëllimin (nijetin) e mirë, dhe në bazë të saj njeriu shpërblehet. E kundërta e kësaj janë veprimet e ndaluara, të cilat nuk duhen kryer. Me veprime të preferuara ose të pëlqyera kihet për qëllim ato vepra që këshillohen të kryhen, ndërkohë të urryera ose të papëlqyera janë ato që nuk këshillohen të veprohen. Veprime të lejuara janë të gjitha ato veprime që as nuk nxiten dhe as nuk kritikohen. Shumica e veprimeve që kryejnë njerëzit hyjnë në grupine fundit që përmendëm.

Thelbi i veprimeve bazohet te qëllimi dhe sinqeriteti, ashtu siç udhëzon Profeti islam kur thoshte: **“Punët lidhen me qëllimet dhe çdo njeriu do t’i takojë ajo që kishte si qëllim.”** (Buhariu & Muslimi)

## Jeta nën hijen e Sheriatit islam

Sheriati përfshin çdo aspekt të jetës së njeriut. Indeksi udhëzues i Sheriatit zakonisht ndahet në katër kode të cilat janë:

- Kodi që lidhet me adhurimet individuale (el-ibadat).
- Kodi që lidhet me shkëmbimet ndërnjerëzore (el-muamelat).
- Kodi që lidhet me martesën dhe divorcin (en-nikah).
- Kodi që lidhet me ndëshkimet penale (el-hudud).

*Vijon në numrin tjetër.*



## Lënia e dyshimit dhe e thashethemeve

Në një shoqëri njerëzish të paditur, disa prej tyre kanë zakone të cilat u janë bërë pjesë e pandarë e jetës. Këto zakone janë ushqimi i dyshimit për të tjerët, futja e hundëve në punët e të tjerëve, apo përpjekja për të mësuar gjërat e fshehta të jetës së tjetrit, të cilat nuk u duhen aspak dhe thashethemet: marrja nëpër gojë e të tjerëve dhe të folurit prapa kurrizit. Këto dy sjellje zakonisht bëshkëshoqërohen, sepse dikush, i cili merr nëpër gojë dikë tjetër vepron kështu sepse ka mendime të padenja, të mbrapshta për të. Po ashtu, dikush që fut hundët në punët e të tjerëve sillet në këtë mënyrë, sepse ai është dyshues. Në udhën e Kur’anit nuk ka vend për këtë lloj sjellje të pakëndshme dhe Allahu i urdhëron besimtarët për ta shmangur atë:

**O ju që keni besuar! Mënjani shumë dyshime, se vërtet disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshironi ndokush prej**


**jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.**

(Sure Huxhurat: 12)

Fjalët e Allahut ndrisin gjithmonë në mendjen e besimtarit, i cili me kujdes largohet nga sjellja e padëshirueshme për Allahun. Ai nuk përpiqet për të mbledhur të dhëna për njerëzit e tjerë me qëllim të keq; nuk flet asgjë të pakëndshme, apo diçka për të cilën është i pasigurt, apo që të lëndonte ndjenjat e të tjerëve. Ai nuk kapet në hamendje ziliqare për një njeri, rreth të cilit nuk di asgjë. Mendimet e tij rreth një njeriu që nuk e njeh, mbeten gjithmonë të mira; ai flet vetëm për anët dhe cilësitë e mira apo tërheqëse të tjetrit. Kështu, duke marrë shembullin e sjelljes së besimtarëve ndaj një shpifje drejtuar grave, Allahu thotë në Kur’an se, kur një besimtar nuk është i sigurt në lidhje me dikë tjetër, duhet të mendojë gjithmonë mirë:

**Kur e dëgjuat këtë përgojim, përse besimtarët dhe besimtarët nuk menduan mirë për njëri-tjetrin dhe të thoshin: “Kjo është shpifje e qartë”?! (Sure Nur: 12)**

Besimtari përpiqet gjithmonë për të menduar mirë për familjen e tij, shokët dhe ata që e rrethojnë. Gjithashtu, ai përpiqet të flasë për udhëzimin dhe t’i bëjë edhe të tjerët të veprojnë po ashtu. Por, njerëzit janë krijuar harrues, si pjesë e sprovës së tyre në këtë botë dhe ata mund të gabojnë, por, kur bëhen të ndërgjegjshëm për sjelljen e tyre të gabuar, ata kërkojnë strehim në mëshirën e Allahut dhe kërkojnë falje prej Tij.



# Promovohet libri “Identiteti islam i Evropës”

Evropa identitetin e vet nuk duhet ta ndërtojë vetëm në krishterizëm dhe hebraizëm por duhet të përfshijë edhe islamin. Pse Evropa sot nuk don të kuptojë që islamizmi dhe krishterizmi janë dy fe që duhet të respektohen reciprokisht? Për këto tema si dhe për islamofobinë e zgjeruar në Evropë është biseduar gjatë promovimit të librit të Ferid Muhiqit “Identiteti islam i Evropës” në Tivar të Malit të Zi. Edhe pse faktet historike tregojnë se Islami më parë, rreth viteve 800 të epokës së re ka ardhur në hapësirat ballkanike para krishterizmit i cili ka ardhur rreth vitit 1200, në Bashkimin Evropian sot nuk duan të pranojnë se për identitetin e kontinentit të vjetër duhet të respektohen si Evropa e krishterë ashtu edhe Evropa islame.

Autor i librit “Identiteti islam i Evropës”, njëherazi edhe kryetar i Akademisë Boshnjake të Shkencës dhe Artit, prof.dr. Ferid Muhiqi thotë se askush në botën islame nuk kërkon revanshin për marrëdhënien e tillë të islamit në Evropë, por vetëm pranimin e fakteve se islami ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin evropian. Kjo edhe përkundër promovimit të ekskluzivitetit krishterë në vlerat evropiane. Por, si në të kaluarën edhe tani të jesh mysliman në sytë e Evropës nuk është gjëja më e dëshiruar. Për këtë profesori Muhiqi ka treguar rrëfimin ironik kur ai ishte 9 vjeç dhe për herë të parë ka dëgjuar për të fortin, guximtarin në një rënë dhe për tinëzarin dhe të pabesin në anën tjetër.

“Kam parë, për fat të keq, se i përkas kategorisë së dytë, të tinëzarisht dhe të pabesit, mbi të cilin çdo kush ka të drejtë ta përplasë dhe feja e të cilit është e turpshme. E turpshme apo mund të themi edhe e paturpshme, dhe kjo është një fjalë e radhë në të cilin edhe pozitivja edhe negativja kanë domethënie të njëjtë. Prandaj në këtë kontekst kam kuptuar se jetoj në botën në të cilin unë jam i detyruar të jem jo vetëm defensiv, por edhe i detyruar të pranoj ndjenjën e zbulimit publik, se jam inferior”, - thotë dr. Muhiqi.

Duke hyrë më thellë në arsyet e islamofobisë por edhe të marrëdhënies negative ndaj pranimin të islamit si pamje pozitive të identitetit evropian, akademiku nga Sarajeva Rusmir Mahmutçehajiqi thotë se Evropa në nivel politik ka prodhuar në vazhdimësi armiq të brendshëm dhe të jashtëm.

“Në Evropë gjatë gjithë historisë të projektit politik të saj, hebrenjtë janë armiq të brendshëm teologjik me ekzistencën e armikut politik të jashtëm, e këta janë myslimanët. Në këtë mënyrë janë formuluar subjektiviteti apo identiteti evropian. Asnjëherë në asnjë periudhë, pa veprimin e fuqishëm të dekonstruimit ne nuk kemi mundur të jetojmë pa këta dy armiq- atij të jashtëm politik, që janë myslimanët, dhe atij të brendshëm teologjik, që janë hebrenjtë”, ka konstatuar akademik Mahmutçehajiqi.

Bashkëjetesa dhe respekti i ndërsjellë nuk ka alternativë, e islami si religjion është element kyç i traditës

më të mirë, traditës së tolerancës ndaj të gjithëve që vijnë nga religjione tjera. Porse, një kohë të gjatë janë duke forcuar qëndrimet negative ndaj islamit dhe myslimanëve në Evropë dhe botë. Për islamofobinë ka folur edhe historiani nga Mali i Zi, Sherbo Rastoder.



“Shtrohet pyetja se nga buron kështjella e islamofobisë bashkëkohore? A ekzistojnë gjasa reale që për këtë çështje të fillojë të mendohet në një mënyrë tjetër radikale, në të cilin Evropa do të jetë hapësirë e mjaftueshme për të gjithë e jo vetëm për të zgjedhurit? A mundet Evropa të fitojë veten në rrugën e vetë njohjes apo prapë do ta rrezikojë dështimin e vet dhe të paguajë haraçin e ri për autizmin e vet civilizues? Përgjigje në këto pyetje ne i ofrojmë dhe po punojmë për këtë. A do të dëgjojë dikush dhe a do të pranojë, mbetet vetëm të spekuojmë. Duke gjykuar nga përvoja e deritanishme, Evropa ka mësuar nga gabimet e veta”, -ka thënë Rastoderi.

Porosia kyçe e intelektualëve boshnjak është se islami është religjioni evropian sikurse është edhe krishterimi, si dhe të dy këto religjione nuk rrjedhin nga kontinenti evropian. Me këtë porosisin që myslimanët evropianë nuk janë më pak evropian në kuptimin etnik nga shumica e evropianëve tjerë, të krishterë.

Po në të njëjtën linjë mendimi është edhe libri me titull “Jam Evropë” i autorit shqiptar Enis Sulstarova. Po citojmë pasazhe të debatit Qosja - Kadare, mbi identitetin tonë kombëtar.

“Shqiptarët në të vërtetë, u takojnë dy qytetërimeve: qytetërimit perëndimor dhe qytetërimit lindor... Duke jetuar në udhëkryqin mes Lindjes dhe Perëndimit, duke qenë të pushtuar, kur prej fuqive perëndimore dhe kur prej fuqive lindore, duke qenë të ndikuar prej qytetërimit të krishterë dhe qytetërimit islamik, shqiptarët kanë marrë çka kanë dashur dhe çka nuk kanë dashur, kanë marrë me dëshirë dhe kanë marrë me dhunë: kultura e tyre, qytetërimi i tyre është bërë kështu bashkim i dy kulturave, i dy qytetërimeve.” (Rexhep Qosja, *Ideologjia e shpërbërjes 2006 - fq.31*)

Sipas Ismail Kadaresë, Qosja ka bërë gabimin se ka nënkuptuar se shqiptarët vetëm përgjysmë i përkasin qytetërimit evropian dhe kjo tezë tregon se shqiptarët nuk janë të bindur për orientimin e tyre proevropian dhe rrjedhimisht, për integrimin në BE. Kjo gjë mund të sjellë pasoja të rënda, sepse “përrjashtimi i gjysmës ose shumicës së kombit shqiptar nga identiteti evropian, do të thotë përrjashtim nga Evropa. Dhe përrjashtimi nga Evropa nuk është larg dëbimit nga Evropa.” (Ismail Kadare 2006 fq. 16-17)



# Roli i shoqërisë civile në luftën kundër islamofobisë

*Xhibangir Ishbilir (Cihangir İşbilir)*

Organizatave islame joqeveritare duhet të zhvillojnë projekte për shtimin dhe përmirësimin e mekanizmave të promovimit të duhur dhe të përfaqësimit të efektshëm në çdo fushë dhe mbi çdo çështje të Islamit në luftën kundër islamofobisë.

## Islamofobia:

*një kërcënim apo një mundësi?*

Islamofobia është një fjalë e përbërë, e formuar nga fjala greke “fobia”, që do të thotë “frikë e pabazë”, dhe islami. Bërja e tyre bashkë në një fjalë është e frikshme, dhe realiteti e ka bërë një prej kërcënimeve më serioze të kohëve tona. Kjo “fobi” relativisht e re, e formuar me një imazh të Islamit përmes efekteve të aksioneve politike, botimeve në shtyp dhe transmetimeve në mjetet e tjera të informimit, e madje prodhimeve letrare dhe artistike antiislame, mund të interpretohet si treguese e sfidave edhe më të mëdha nëse nuk përkufizohet siç duhet dhe të luftohet me një plan veprimi strategjik.

Sot, në një kohë kur asgjë nuk është e mundur të mbetet lokale, kur janë siguruar kushtet e nevojshme dhe janë vënë në punë marrjet e dhënit, kërcënimet si islamofobia mund të shndërrohen në mundësi. Mënyra më e efektshme e arritjes së këtij objektiv është së paku kryerja e veprimeve që janë aq sistematike, të gjera, të volitshme dhe të vazhdueshme, sa veprimet e atyre që po i fryjnë kësaj frike të paqenë.

Në lidhje me këtë çështje, detyrat jetike ubien institucioneve të shoqërisë civile, që e marrin forcën e tyre prej shoqërisë, aktivitetet e të cilave reflektojnë mbi të dhe marrëdhëniet e të cilave me shoqërinë janë shumë më të forta se ato të burokracisë shtetërore. Këto detyra mund të analizohen nën tre tituj, “Promovim i duhur”, “Përfaqësim i efektshëm” dhe “Mbrojtja e të drejtave”.

## 1 – Promovim i duhur

Kur analizohen me kujdes studimet dhe botimet mbi islamofobinë, mund të arrihet lehtë në përfundim se mungesa e informacionit të duhur mbi Islamit luan një rol domethënës në nxitjen e politikave islamofobike dhe të botimeve të qendrave antiislame. Ka studime të rëndësishme që tregojnë se kjo “injurancë”, dhe “tendenciozitetet” apo “opinionet paragjyquese” rezultuese, janë tejet të përhapura, jo vetëm në vendet jomuslimane, por gjithashtu në vendet islame.

Një arsye për këtë situatë, që mund të shpjegohet po ashtu duke iu referuar të metave të institucioneve të davet-it,

është promovimi jo i duhur i Islamit, apo paaftësia për të përcaktuar dhe krijuar mekanizmat dhe metodat e “promovimit të duhur”.

Një nivel i duhur promovimi, i cili mund të bëhet i mundur nëpërmjet interpretimit të të vërtetave të Islamit dhe të mesazheve kur’anore e profetike, në një mënyrë të përshtatshme për nevojat e kohës dhe të kuptuarin e njerëzve të kohës, e përmes përdorimit të efektshëm të mjeteve të informimit, ka për të qenë antidoti më i mirë për mendimet dhe veprimet islamofobike, për sa kohë që i ngërthen të tëra shtresat e shoqërisë dhe ka fuqinë për të mos lënë asnjë boshllëk.

Kur organizatat e shoqërisë civile që e përqendrojnë vëmendjen e tyre në propagandimin e Islamit të kenë sistemet e duhura të promovimit, në vendet islame apo joislame, ato nuk do të lënë hapësira për politikën dhe aksionet islamofobike, dhe kanë për t’i eklipsuar. Kur organizatat elastike dhe të efektshme të shoqërisë civile me hapësira më të mëdha për manovrim dhe mekanizma më të shkurtra vendimmarrjeje bashkohen me metoda të duhura dhe me një frymë vullnetarizmi, rezultatet ka për t’i tejkaluar mjaft përpjekjet e bëra intelektuale dhe fizike. Është vënë re se janë organizatat e përqendruara vetëm në një çështje të veçantë dhe në një grup të shoqërisë që kanë patur më tepër sukses, e jo organizatat e shoqërisë civile që po kryejnë aktivitete davet-i në të gjitha fushat dhe për të tëra shtresat e shoqërisë. Dhe kjo mund të jetë për arsye se ne jetojmë në një kohë që favorizon specializimin.

## 2 – Përfaqësim i efektshëm

Është e dukshme se bota islame ka sot një problem përfaqësimi në thuajse çdo sferë të jetës. Problemi i përfaqësimit në lëmenjtë e shkencës, artit, të mjeteve të informimit, ekonomisë, politikës dhe fesë, është pasojë e hidhur e tëhuajtjes dhe përçarjes artificiale midis bashkësive dhe vendeve islame.

Ndonëse ngritja e institucioneve të forta dhe shfaqja e figurave me ndikim në fushat e sipërpërmendura ngjan nganjëherë ta riparojë këtë problem, këto janë vetëm zgjidhje të përkohshme apo të pjesshme, që nuk e zhdukin tërësisht problemin. Dobësia e institucioneve civile dhe burokratike, çuarja dëm e energjisë dhe burimeve, e sjellë nga përçarja dhe mungesa e bashkëpunimit, dhe, çfarë është më e rëndësishmja, paaftësia fatkeqe për të zhvilluar kapacitetin, si edhe mungesa e përparimit institucional, e shkaktuar

nga mungesa e nivelit të nevojshëm të ndarjes së përvojave, mund të përmenden si faktorë përgjegjës për këtë problem.

Efektshmëria e përfaqësimit është po aq e rëndësishme sa legjitimiteti i tij. Njohja apo zgjedhja e një institucioni apo figure përfaqësuese nga shoqëria nuk është e mjaftueshme. Ato duhet të kenë kapacitetin dhe mekanizmin për të qenë përfaqësuese të denja të njerëzve dhe ideve që përfaqësojnë.

Është jetike që organizatat joqeveritare të cilat janë në një marrëdhënie ndërvepruese me shoqërinë t’i kushtojnë vëmendje të madhe detyrës së përfaqësimit të efektshëm. Thjesht pasja e vlerave nuk mjafton në vetvete për t’i bartuar ato në bashkësitë e tjera. Është e domosdoshme të krijohen mekanizmat e duhura të promovimit dhe përfaqësimit të efektshëm, në përpjestim me peshën dhe fuqinë e vlerave.

Krizat islamofobike na kanë bërë ne ta shohim më qartë problemin e përfaqësimit. Mungesa e institucioneve të efektshme të përfaqësimit që janë në gjendje të parandalojnë botimet dhe transmetimet islamofobike para se të ngjasë një krizë, dhe të sigurojnë që protestat legjitime të qëndrojnë brenda një kornize të ligjshme pas një krize, e vënë botën islame në pozitën e të akuzuarit, ndërsa në fakt janë shpesh me të drejtën.

## 3 – Mbrojtja e të drejtave

Islamofobia dhe idetë, publikimet, politikën, si edhe rregullimet ligjore e reagimi shoqëror i shkaktuar nga këto elemente, që janë rezultat i ndjenjave antiislame dhe që ushqehen me islamofobinë, fyejnë dhe shqetësojnë muslimanët, shkelin të drejtat e tyre bazë njerëzore, e kufizojnë hapësirën e tyre të jetesës, dhe e prishin statusin e tyre shoqëror.

Ekzistenca dhe profesionalizmi i organizatave të shoqërisë civile të ngritura për të mbrojtur të drejtat e muslimanëve të cilëve u janë cenuar të drejtat dhe nderi, të cilët janë fyer dhe diskriminuar, të prekur nga praktikatat dhe publikimet islamofobike, dhe të cilat si rezultat luftojnë në fushën ligjore dhe politike, është një çështje që ka rëndësi jetike në luftën kundër islamofobisë dhe antiislamizmit.

Numri dhe cilësia e atyre organizatave islame joqeveritare që punojnë për mbrojtjen e të drejtave dhe luftojnë kundër diskriminimit është ende minimale, si në vendet islame dhe joislame. Puna për mbrojtjen e të drejtave kundër këtyre llojeve të diskriminimit, që mendohet të jetë më e përhapur në vendet ku

muslimanë janë një pakicë, por, përkundrazi, është gjithashtu mjaft e shtrirë në vendet islame, është tejet e vështirë, me rrezik, dhe kërkon profesionalizëm.

Një tipar i rëndësishëm i organizatave joqeveritare muslimane që luftojnë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që e rrit forcën dhe efektshmërinë e tyre, është se e kanë aspektin “civil” të fuqishëm dhe janë jashtëzakonisht të kyçura ndaj manipulimeve politike.

## Përfundim

Edhe pse rregullimet ligjore janë deri diku një frenim dhe pengim, ato nuk përbëjnë formulën për një zgjidhje të përhershme, të efektshme dhe vijuese. Në luftën kundër islamofobisë dhe antiislamizmit u bien detyra të rëndësishme organizatave të shoqërisë civile, po aq sa qarqeve politike, qeverive dhe mjeteve të informimit, që kanë mundësinë për të ndikuar.

Përmbushja e këtyre detyrave, të analizuar nën tre titujt e mësipërm, nënkupton projekte të hulumtuara mirë. Sot, fatkeqësisht, bota islame nuk ka nxjerrë ende një projekt që të jetë në gjendje të ndikojë mbi tërë botën në luftën kundër islamofobisë. Për këtë arsye, çfarë ne shohim janë vetëm kundërpërgjigje nga reflekset, dhe ngaqë projektet e zhvilluara nuk janë akoma mjaftueshmërisht të fuqishme dhe të suksesshme, efekti i tyre është veç i përkohshëm dhe i kufizuar.

Në të vërtetë, bota islame po përjeton një pamjaftueshmëri të madhe projektesh në këtë fushë. Organizatat joqeveritare duhet të zhvillojnë projekte për shtimin dhe përmirësimin e mekanizmave të promovimit të duhur dhe të përfaqësimit të efektshëm në çdo fushë dhe mbi çdo çështje të Islamit, si mbi Kur’anin dhe jetën e Profetit. Qarqet investuese dhe biznesi në botën islame duhet t’i mbështesin këto lloj projektesh, si dhe programet për përgatitjen e njerëzve të kualifikuar për t’i marrë përsipër këto projekte. Veç kësaj, qeveritë dhe bashkësitë e botës islame duhet të inkurajojnë ngritjen dhe forcimin e institucioneve që kanë për të punuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe do të luftojnë kundër diskriminimit.

Për sa kohë organizatat joqeveritare do të marrin përgjegjësitë e tyre në këto fusha, dhe ta çojnë përpara punën e tyre me mjete dhe metoda të përshtatshme, ne kemi shpresën se islamofobia ka për t’u dobësuar.

# Muslimanët e kapërcyen Atlantikun përpara Kolombit

Firas El-Hatib (Firas Al-Khateeb)

Autori është Bashkërendues i Përgjithshëm i Unionit të Organizatave Joqeveritare të Botës Islame.

Poezia e vjetër që shumica e nxënësve amerikanë njohin fillon kështu, "Kolombi kapërceu oqeanin e kaltër më 1492...". Në të vërtetë, Kolombi e kaloi Atlantikun në vitin 1492 në emër të kurorës spanjolle dhe zbriti në pjesën e Karaibeve të Amerikës së Veriut.

Për qindra vite thjeshtë është pranuar se Kolombi ishte eksploruesi i parë që me guxim të pashoq kaptoi detin dhe "zbuloi" Amerikën. Por kjo histori nuk i bën më dot ballë dijes moderne.

Nuk është e nevojshme të thuhet se njerëzit e parë që e zbuluan vërtet Amerikën ishin paraardhësit e amerikanëve vendas, të cilët mbase kaluan në Amerikën e Veriut përmes Rusisë dhe Alaskës rreth 12.000 vite të shkuara. Diskutimi i "zbulimit" të Amerikës nga europianët, afrikanët apo aziatikët është një fyerje për historinë e popujve të saj indigjenë. Përndryshe, është e rëndësishme të njihen shpirtat e parë guximtarë që do ta kapërcenin Oqeanin Atlantik me anije, dhe teoria e Kolombit nuk e trajton si duhet historinë e tyre.

Ndërsa njohuria e përgjithshme rreth Kolombit është se ai jetoi në një kohë kur çdokush pretendonte se toka është e rrafshët, qartësisht nuk është kështu. Dijetarët e lashtë grekë, të tillë si Aristoteli dhe Pitagora, sugjeronin se toka ishte, në fakt, e rrumbullakët.

Që gjatë Epokës së Artë Muslimane (rreth viteve 750-1100) që nisi studimi i përparuar akademik mbi formën dhe madhësinë e tokës. Në kundërshtim me atë që mund të besojnë pjesa më e madhe e njerëzve, në ato kohë ishte perceptimi i përgjithshëm se toka nuk qe e rrafshët. Në vend të kësaj, debati bëhej mbi atë se sa e madhe ishte toka. El-Memuni, kalifi abasid, mblodhi në Bagdad në fillim të viteve 800 mendjet më të ndritura të kohës, të cilët përlllogaritën perimetrin e tokës, dhe qenë larg madhësisë së vërtetë me vetëm 4 për qind.

Duke e ditur se toka ishte e rrumbullakët, dhe duke e ditur me një shkallë shumë të mirë saktësie madhësinë e saj, pa teknologjinë moderne që ne kemi sot, disa muslimanë që nuk u trembej syri duhet të jenë përpjekur qindra vite para Kolombit t'i bien rrotull tokës. Prova e këtyre udhëtimeve është përpara nesh, në të bardhë dhe në të zezë.

## Spanja muslimane

Gjeografi dhe historiani i madh musliman, Ebu Hasan el-Mesudi, shkroi më 956 mbi një lundrim në vitin 889 nga el-Andaluzi (Spanja muslimane), që zgjati muaj me radhë drejt perëndimit. Ata gjetën në fund

një hapësirë të madhe toke matanë oqeanit, ku bënë tregti me vendasit, dhe më pas u kthyen në Europë. El-Mesudi e shënon këtë tokë përtej oqeanit në hartën e tij të famshme, dhe i referohet asaj si "toka e panjohur".

Në histori janë regjistruar dy udhëtime të tjera akoma nga Spanja muslimane për në Amerikë. Njëri ishte në vitin 999, dhe u udhëhoq nga Ibn Ferruhu, nga Granada. Tjetri është përmendur nga mendja gjeniale e gjeografit el-Idrisi, i cili punoi në vitet 1100 në Sicilinë shumëkulturore dhe tolerante nga pikëpamja fetare të mbretit Roxher II. Ai shkruajti mbi një grup muslimanësh të cilët lundruan për 31 ditë nga Lisbona për në perëndim dhe zbritën në një ishull në Karaibe.

Ata qenë marrë rob për pak ditë nga amerikanët vendas në atë ishull. Në fund, u lanë të lirë kur një përkthyes që fliste arabisht e që jetonte mes vendasve u rregulloi lirim. Paskëta lundruan për në el-Andaluz dhe treguan historinë e tyre. Pjesa e rëndësishme e këtij rrëfimi është ekzistenca e një folësi të arabishtes midis vendasve, që tregon se duhet të ketë patur më tepër kontakt të paregjistruar midis botës arabe dhe Amerikës.

## Afrika Perëndimore

Kan një pjesë tjetër të botës muslimane që kishte kontakt me Amerikën përpara Kolombit. Në vitet 1300 ekzistonte në Afrikën Perëndimore një perandori e fuqishme dhe tepër e pasur, e quajtur Mali. Udhëheqësi më i famshëm i kësaj perandorie ishte mansa (mbreti) Musa. Ngjarja më e paharrueshme e sundimit të tij qe udhëtimi epik i haxhit në vitin 1324.

Karvani me mbi 60.000 njerëz la përshtypje ngado që vajti, duke përfshirë Egjiptin, ku mansa Musa tregoi historinë se si erdhi në pushtet. Vëllai i vet, Ebu Bekri, ishte mansa para se të qe ai.

Ebu Bekri, gjatë sundimit të tij, dërgoi një flotë prej 400 anijesh për të eksploruar Oqeanin Atlantik. Vetëm një anije u kthye, njerëzit e së cilës treguan se ata gjetën tokë matanë oqeanit. Atëherë mansa Ebu Bekri bëri gati një flotë prej 2000 anijesh, me të cilën lundroi vetë, në udhëtimin në oqean për nga perëndimi. Për ta nuk u dëgjua më kurrë.

Ndërkohë që nuk ka asnjë dokumentim në Mali mbi rezultatin e atij udhëtimi, ka dëshmi të arritjes së tyre në Amerikë. Ekzistojnë një numër vendesh arkeologjike në Amerikën e Veriut dhe të Jugut që dëshmojnë për atë prani maliane. Piratë dhe eksplorues të hershëm spanjollë bënë

të ditur për qytete të braktisura në Brazil që kishin mbishkrime të njëjta me gjuhën e mandinkës (popullit të Malit).

Mbishkrime të tjera në gjuhën e mandinkës u gjetën dhe në Shtetet e Bashkuara. Pranë lumit të Misisipit ekzistojnë shumë mbishkrime që regjistruan eksplorimin e tyre të Amerikës. Në Arizona u gjet një mbishkrim që thotë, "Elefantët janë të sëmurë e të zemëruar. Aktualisht ka shumë elefantë të sëmurë." Ky mbishkrim përfshin gjithashtu një vizatim shkel e shko të një elefanti. Elefantët nuk janë karakteristikë për Amerikën. Ato u sollën nga mandinka në Amerikë, dhe mbishkrimet janë provë e udhëtimit të suksesshëm të mansa Ebu Bekrit mbi 100 vite përpara Kolombit.

## Perandoria otomane

Në vitin 1929 u bë një zbulim i habitshëm në Stamboll. U gjet një hartë e skicuar më 1513 nga hartografi otoman Piri Reis. Reisi shkruante se kjo hartë qe bazuar në burime të mëhershme, duke përfshirë hartat e lashta greke dhe arabe, dhe hartat nga Kristofor Kolombi, i cili kishte lundruar vetëm 21 vite më herët. Ajo çka bie në sy në këtë hartë është niveli i imtësisë së saj, që i shtrëngoi historianët ta rivlerësojnë teorinë e eksplorimit të Kolombit.

Harta tregon qartë bregun lindor të Amerikës së Jugut, që është në pozicion të pagabimtë në lidhje me Afrikën. Bregu i Brazilit është treguar me hollësi të jashtëzakonshme, me shumë lumenj të vendosur saktë në hartë. Edhe pse Reisi i shfrytëzoi si një burim hartat e Kolombit, ky i fundit nuk vajti kurrë në Amerikën e Jugut. Kështu që Reisi duhet ta ketë marrë atë nga hartat më të hershme muslimane, të cilat i përdori si burime. Për më tepër, harta e Reisit përfshin vargmalin e Andeve, të paeksploruar nga europianët deri në vitet 1520, një dekadë pas bërjes së hartës së Reisit!

Piri Reisi e bazoi hartën e tij në burime të mëhershme, që kishin qartas një perceptim shumë të mirë të Amerikës dhe e kishin eksploruar mirë zonën përpara europianëve të parë. Harta është mbase dëshmia më e fortë fizike e eksplorimit musliman të Amerikës përpara Kolombit.

## Çfarë tha Kolombi?

Me tërë këtë dëshmi të eksplorimit musliman përpara udhëtimit të Kolombit më 1492, a është e mundur që Kolombi vetë ta dinte se ai nuk ishte i pari? Është më tepër se e mundur që të jetë kështu. Kolombi lundroi nga Spanja në të njëjtin vit që u shkatërrua

gjatë Rekonkuistës dinastia e fundit muslimane e Iberisë.

Shumë prej banorëve të Iberisë ishin ende muslimanë, dhe mbartnin me vete dijen e Epokës së Artë Muslimane. Njerëz të shumtë në udhëtimin e Kolombit qenë morisko; muslimanë të cilit ishin shtrënguar të konvertoheshin në Katolicizëm ose të vdisnin. Kolombi mund të ketë dëgjuar prej muslimanëve të Spanjës mbi Botën e Re, dhe kështu qe frymëzuar për t'u nisur për eksplorim.

Me të arritur në Amerikë, Kolombi regjistroi shembuj të shumtë të muslimanëve tashmë të pranishëm. Ai bëri komente mbi arin që kishin vendasit, i bërë në të njëjtën mënyrë, me të njëjtin aliazh, siç e bënin muslimanët e Afrikës Perëndimore. Për më shumë, Kolombi shënon se fjala vendase në atë zonë për arin, isguanin, është shumë e ngjashme me fjalën në gjuhën mandinka për floririn, ganin, që vjen ndoshta nga fjala arabe për pasurinë, gina.

Kolombi njoftoi të ketë parë më 1498 një anije të mbushur me mallra, të drejtuar për në Amerikë, plot me afrikanë që ndoshta po shkonin për të bërë tregti me amerikanët vendas. Kolombi shënon po ashtu në ditarin e tij se amerikanët vendas i treguan mbi afrikanët e zinj që vinin rregullisht për të bërë tregti me ta.

Edhe Kolombi e dinte se ai nuk ishte i pari që e kishte kapërcyer Oqeanin Atlantik.

## Përfundime

Është e qartë se teoria që Kolombi zbuloi Amerikën nuk është asgjë tjetër, veçse një përrallë e vjetër, e cila nuk i ka rezistuar provës së kohës. Nuk ka dyshim se era kolombiane ishte një kohë me rëndësi të jashtëzakonshme në historinë botërore, që ndryshoi përgjithmonë mënyrën e të jetuarit në Amerikë dhe në Europë. Megjithatë, ai nuk qe i pari që do të bënte kalimin për në Amerikë.

Ekzistojnë dëshmi nga arabët, afrikanoperëndimorët dhe otomanët mbi udhëtimet muslimane për në Amerikë shumë përpara Kolombit dhe Europës krishtere. Tekstet shkollore vijojnë për çfarëdo arsye ta ngrej në lart e t'i thurin lavde udhëtimit të Kolombit dhe kurajës së ekuipazhit të tij, të "parit" që do të kalonte matanë Atlantikut. Kjo ide ka nevojë dukshëm për t'u rishqyrtuar në dritën e dëshmi nga eksplorimet më të hershme muslimane, për t'ia bërë të njohur publikut të përgjithshëm kontributet e tyre.

Përzgjedhja dhe përktheu:  
Bujar M. Hoxha

## Bar Restorant Piceri "Ishulli Luanëve"

Në dalje të Tiranës, larg zhurmave të përditshme, në qetësinë dhe në ajrin e pastër, do të shijoni gatime tradicionale dhe hallall të guzhinës sonë.

Menu e pasur dhe një pamje piktoreske e lumit Erzen, e cila do t'ju mahnisë.

Ju mirëpresim!



Adresa: Rruga nacionale  
Tiranë-Durrës, Ndroq, km 17

Mobile: 00355 682153105

## PRODUKTE NATYRALE

*Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!*



Adresa: Rr. e Kavajës,  
rrugica përballë  
xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë  
Cel: 0672812607 / 0672821589

Produkte të firmës "Phenomenal", vaj të farës së zezë  
Mjaltë me polen, mjaltë sidri, etj.  
Hurra arabie të freskëta dhe ujë zemzemi  
Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe vajra bimore "Tact"  
Shampo bimore "Touch Me" nga Tajlanda  
Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojlojshme  
Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane  
Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak  
Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar  
Kohël bimor për sytë etj.

www.produktenatyrale.com  
Email: agimballa@hotmail.com

